# DËSHMI ARKIVI

**A-456869**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Çelet ekspozita me foto të rralla të Nënë Terezës në COD |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/kulture/elet-ekspozita-me-foto-te-rralla-te-nene-terezes-ne-cod-i587010` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 07:15:39 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 07:12:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `98f9fc1a59cc2c7564e2a1e51036ebefaf003b6beb99bbfcb1b24eb8608018fa` |
| TEKSTI | `3a1db70ecdf1afdbee96f9ecd8ba50f52103c082902f398714e0b4b3e247dff8` |
| PAMJA | `aea3f5e31fcc6f53f4295dfdeea05b9f1457f69e6eddb295c7614c8f7c5ac04d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `b0d93f752b68e3042433e6ca3df56a061639dc84614f637af22c674c95af9a20` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `2efc04bea43acf0f6a2e38be2863702e338fd789cd0cf3c1cc14a88f36ac9872` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/b0d93f752b68e3042433e6ca3df56a061639dc84614f637af22c674c95af9a20`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Çelet ekspozita me foto të rralla të Nënë Terezës në COD

19 Shtator 2026, 09:12Kulturë TEMA



Foto të rralla të Nënë Terezës në misionet e saj në Indi dhe në vizat në Shqipëri u ekspozuan nga Ambasada e Indisë në ambientet e Qendrës për Hapje dhe Dialog.

Ekspozita paraqet trashëgiminë e jashtëzakonshme humanitare të Shenjtores, që ia dedikoi jetën shërbimit ndaj më të varfërve dhe më të pambrojturve

*"Nënë Tereza mishëron më së miri Shqipërinë dhe popullin e saj. Megjithatë, thirrja e jetës së saj gjeti një jehonë në ethosin mijëravjeçar të Indisë, se hyjnorja është në çdo qenie njerëzore dhe se t'u shërbesh të varfërve dhe të pastrehëve do të thotë të adhurosh Zotin"*, tha Ravindra Prasad Jaiswal, ambasadori i Indisë në Shqipëri..

Përveçse laureate e Nobelit për Paqe dhe humaniste globale, ekspozita e paraqet Nënë Terezën si një urë lidhëse midis dy kombeve dhe kulturave, që 70 vite më parë vendosën marrëdhëniet diplomatike.

*"Kontributi i saj i jashtëzakonshëm për Indinë ka krijuar një lidhje midis dy vendeve tona që shkon shumë përtej miqësisë, një lidhje e afërsisë së qëndrueshme"*,deklaroi ai.

*"Sot, gjithnjë e më shumë identitetet përcaktohen përmes dallimeve, sesa përmes asaj që kanë të përbashkët. Nënë Tereza na mëson të kundërtën. Ajo nuk e dallonte njeriun nga pasaporta, kombësia apo feja, por nga nevojat dhe dinjiteti"*, u shpreh Ferit Hoxha, ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Duke vëzhguar fotot që pasqyrojnë misionet e bamirësisë dhe përfundojnë me ceremoninë mortore në Kalkutë, diplomatët e vlerësuan Nënë Terezës shprehjen më të fuqishme të lidhjes mes dy vendeve, rrënjët e saj ishin shqiptare dhe misioni i jetës u përmbush në Indi, ndërsa mesazhi i saj u bë universal!
A.K./TemA

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Teuta: anatomia e një simboli, estetika e pushtetit dhe paradoksi i monumentit]

21:32 Kulturë

Ekspozohen 101 vepra arti në Lagjen e Parë të Gjirokastrës

17:19 Kulturë

[Homazh për regjisorin e madh italian Luchino Visconti në edicionin e 24-t të TIFF]

16:34 Kulturë

[Shqipëria merr pjesë në "Platforms Project"]

15:17 Kulturë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.